



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.14.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KËSHILLIT TË KOSOVËS PËR
TRASHËGIMI KULTURORE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Hysen Boqolli (Udhëheqës Ekipi), dhe Vlora Duraku

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	17
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	20

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Udhëheqësen Ekzekutive dhe stafin e saj për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 13 nëntor 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyrat vjetore financiare të theksuara në memon e planifikimit të auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar).*

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore ende nuk ka arritur të dizajnoj një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Ata, përballen me sfidën e funksionimit dhe ushtrimit të mandatit të tyre si pasojë e mungesës së anëtareve të këshillit, të cilëve ju ka skaduar mandati në vitin 2012, ndërsa Kuvendi i Kosovës akoma nuk i ka emëruar anëtarët e rinj të këtij këshilli.

Në mungesë të anëtareve të këshillit dhe me qëllim të vazhdimit të aktiviteteve organizative dhe ligjore, Udhëheqësja ekzekutive ka ndër marrë disa veprime të cilat tejkalojnë kompetencat dhe përgjegjësit e saj. Ndërsa, nga aspekti i rëndësisë me të ulët kontrolle shtesë nevojiten edhe në menaxhimin e proceseve të prokurimit.

Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë si në vijim:

Udhëheqësja ekzekutive e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore duhet të siguroj se:

- Plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor praktik dhe sfidues për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat me prioritet me të lartë. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga udhëheqësja ekzekutive në baza të rregullta; dhe
- Janë rishqyrtuar vendimet e nxjerra lidhur me inicimin për hartimin e kornizës ligjore (draft ligjit dhe strategjisë kombëtare për fushën e trashëgimisë kulturore). Gjithashtu duhet të sigurojë se të gjitha pagat shtesë për punë jashtë orarit, buxhetohen dhe shpenzohen në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturën tonë të auditimit dhe është zotuar se do të adresojnë rekomandimin e dhënë.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) të përgatisë pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

KKTK, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij; dhe
- Kërkesat e rregullores 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga KKTK kërkohet të adresojë edhe obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet operative vjetore (të përformancës);
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në Ministrinë e Financave (MF);
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit;
- Planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve; dhe
- Inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive në pronësi të KKTK-së.

Te gjitha kërkesat e lartcekura ishin përmbushur me kohë nga KKTK-ja.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i KKTK-së ka bërë progres të rëndësishëm në adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të vitit 2012. Kjo tregon gatishmërinë e tyre për të përmirësuar kontrollet në vazhdimësi. Ne e inkurajojmë menaxhmentin që të merr masat dhe veprimet e duhura për t'i finalizuar edhe rekomandimet të cilat janë në proces të adresimit.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të KKTK-së ka rezultuar në tetë rekomandime kryesore. KKTK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, pesë rekomandime ishte adresuar plotësisht, ndërsa tri ishin adresuar pjesërisht. Rekomandimet të cilat ishin në proces të adresimit, kanë filluar të adresohen në fillim të vitit 2014. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe të rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Menaxhmenti i KKTK-së ende nuk ka arritur të dizajnoj një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Ata, përballen me sfidën e funksionimit dhe ushtrimit të mandatit të tyre si pasojë e mungesës së anëtareve të këshillit, të cilëve ju ka skaduar mandati në vitin 2012, ndërsa Kuvendi i Kosovës akoma nuk i ka emëruar anëtarët e rinj të këtij këshilli.

Në mungesë të anëtareve të këshillit dhe me qëllim të vazhdimit të aktiviteteve organizative dhe ligjore, Udhëheqja ekzekutive ka ndërmarrë disa veprime të cilat tejkalojnë kompetencat dhe përgjegjësit e saj. Ndërsa, nga aspekti i rëndësisë me të ulët kontrolle shtesë nevojiten edhe në menaxhimin e proceseve të prokurimit.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për KKTK dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	161,718	161,718	147,831	176,104	126,470
Granti i Qeverisë -Buxheti	161,718	161,718	147,831	167,104	126,470

Nga tabela më lartë vërejmë se buxheti final nuk ka pësuar ndryshime nga ai fillestar. Gjatë këtij viti ata kishin shfrytëzuar 147,831€, ose mbi 91% të buxhetit final. Krahasuar me realizimin e buxhetit të vitit 2012 (prej 97%), për vitin 2013 vërejmë një rënie prej 6%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve ne kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	161,718	161,718	147,831	176,104	126,470
Pagat dhe Mëditjet	77,718	77,718	65,339	77,718	63,030
Mallrat dhe Shërbimet	81,000	81,000	80,267	80,685	61,020
Shërbimet komunale	3,000	3,000	2,224	2,417	2,420
Investimet Kapitale	-	-	-	15,283	-

Realizimi i mirë i buxhetit vërehet edhe nëse e analizojmë sipas kategorive ekonomike. Të mallrat dhe shërbimet buxheti final ishte shpenzuar në 99%. Përjashtim nga kjo bënë kategoria e pagave dhe mëditjeve në të cilën realizimi i buxhetit ishte me i ulët në 84%. Njëra ndër arsyet e realizimin të ulët në këtë kategori ishte mungesa e emërimit të anëtarëve të Këshillit të KKTK-së.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Pasi që KKTK është institucion i vogël është arritur një marrëveshje me Kuvendin e Republikës së Kosovës që procedurat e prokurimit të udhëhiqen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Për pjesën me të madhe të prokurimeve KKTK ka shfrytëzuar kontratat e Kuvendit të Kosovës, më përjashtim të gjashtë kontratave në vlerë totale 4,646€, të cilat janë nënshkruar në kuadër të KKTK-së. Ne kemi testuar procedurat e prokurimit dhe pagesat përmes prokurimit dhe kemi identifikuar një çështje e cila nuk kategorizohet si çështje me prioritet të lartë.

Çështja 1 - Mungesë e informimit të operatoreve të eliminuar - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas nenit 54 të LPP-së, Nëse autoriteti kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt.

Në kontratën “Lyerja e mureve brenda ndërtesës së KKTK-së”, pas kryerjes së vlerësimit nga ana e komisionit të vlerësimit, zyrtari i prokurimit nuk kishte njoftuar OE-të e pasuksesshëm lidhur me dhënien e kontratës.

Rreziku Mos informimi i OE-së të pasuksesshme, rritë rrezikun për mungesë të transparencës, dhe kufizon mundësinë për ushtrimin e ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Rekomandimi 1 Udhëheqësja ekzekutive duhet të sigurojë se ekziston një proces i vazhdueshëm i informimit për OE-të e pasuksesshëm. Kjo do ta zhvillojë transparencën dhe konkurrencën në menaxhimin e shpenzimeve.

4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne kemi testuar pagesat për udhëtime jashtë vendit, komunalit dhe shërbime tjera.

Testet tona kanë shpalosur parregullsitë si në vijim:

Çështja 2 - Regjistrimi i shpenzimeve në kode joadekuate - Prioritet i mesëm

E gjetura Gjashtë pagesa në vlerë totale 7,500€, për angazhimin e eksperteve të jashtëm ishin regjistruar gabimisht në kodin 13460 (shërbime kontraktuese tjera), përderisa kodi përkatës të ishte 13440 (shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse).

Rreziku Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike joadekuate, redukton efektivitetin e menaxhimit të buxhetit, saktësinë dhe plotësinë e raportimit financiar.

Rekomandimi 2 Udhëheqësja ekzekutive duhet të sigurojë kontrolle shtesë në kuadër të sektorit të pagesave, në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar.

Çështja 3 - Marrja e vendimeve jo në pajtim me kompetencat - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas statutit të KKTK-së, neni 5 përcakton detyrat e Anëtarëve të Këshillit (të Këshillit). Pika 1. Detyre e tyre është të përpilojnë politikën/strategjinë kombëtare dhe të përcaktojnë prioritetet në fushën e trashëgimisë kulturore, ndërsa në pikën 2. Përgjegjësi e tyre është të marrin masa për përparimin dhe kompletimin e infrastrukturës ligjore.

Udhëheqësja Ekzekutive e KKTK-së, në mungesë të anëtareve të këshillit ka anashkuar kërkesat e lartpërmendura dhe ka formuar grupin punues për hartimin e projekt-ligjit për KKTK-në, si dhe Planin kombëtar të veprimit "Parandalimi i trafikimit të veprave të artit dhe kulturës". Lidhur me këto ka angazhuar dy (2) konsulent të jashtëm për të ofruar këshilla për projektet e lartcekura. Pagesa për këtë qëllim ishte 7,500€.

- Rreziku** Marrja e vendimeve për angazhimin e konsulentëve të jashtëm dhe për përgatitjen e draft-ligjit e strategjisë në kundërshtim me kompetencat dhe ligjin, rrite rrezikun e krijimit të hapësirës për mundësin e keqpërdorimit të parasë publike.
- Rekomandimi 3** Udhëheqësja ekzekutive duhet të rishqyrtoj vendimet e nxjerra lidhur me iniciimin për hartimin e kornizës ligjore (draft ligjit dhe planit kombëtar të veprimit). Iniciimi, për hartimin e tyre duhet të bëhet nga organet kompetente (Anëtarët e Këshillit).

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Në ligjin e buxhetit, KKTK ka paraparë 16 punonjës (përfshirë kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e këshillit), ndërsa në fund të vitit kishte gjithsej tetë (8) të punësuar, prej tyre shtatë më orar të rregullt dhe një më gjysmë orari. Arsyeja e mos realizimit të planit ndërlidhet më mos arrijtjen e emërimit të anëtareve të këshillit.

Ne kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishin shpenzuar 65,339€ apo 84% të buxhetit final. Në kuadër të këtyre shpenzimeve 14,781€ janë shpenzimet për shtesa për punë jashtë orarit. Ne identifikuam çështjen si në vijim:

Çështja 4 - Aprovimi i punëve / pagesave shtesë jashtë orarit të punës - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Sipas Ligjit Nr. 03/L-147 Për Pagat e Nëpunësve Civil Neni 19.2. "Institucionet e administratës publike çdo vit mund t'i paguajnë shtesa stafit të tyre vetëm me kusht që shumica e përgjithshme e shtesave dhe pagave bazë të jetë përcaktuar nga ministria përgjegjëse për financa, brenda llogarisë së përgjithshme të përcaktuara për institucionin përkatës".
- KKTK edhe pse gjatë vitit 2013 nuk kishte mjete të buxhetuara për shtesa për punë jashtë orarit, ata për këtë qëllim kishin paguar 14,781€.
- Rreziku** Pagesa/aprovimi i punëve shtesë në mungesë të mjeteve të buxhetuara si dhe në kundërshtim më bazën ligjore, krijon hapësira për keqpërdorimin e parasë publike.
- Rekomandimi 4** Udhëheqësja Ekzekutive duhet të sigurojë se të gjitha pagat shtesë për punë jashtë orarit, buxhetohen dhe shpenzohen në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Sipas regjistrit kontabël (SIMFK), vlera e pasurisë mbi 1,000€ e KKTK ishte 19,436€, ndërsa pasuria jo-kapitale nën 1,000€ ishte 9,092€. Stoqet ishin në vlerë 1700€.

Ne kemi verifikuar ekzistencën fizike të pasurive mbi €1,000 të raportit të nxjerrë nga SIMFK dhe kemi konstatuar se ekzistonin kontrole në mira në menaxhimin e pasurive.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.4.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

Pasqyra e detyrimeve të papaguara e shpalosur ndaj furnizuesve në fund të vitit 2013 ishte në vlerë 367€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014.

KKTK, ka dorëzuar raporte të rregullta mujore në pajtim me Rregullën financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Në bazë të kërkesave të Udhëzimit Administrativ nr.23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), KKTK nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie.

Për vitin 2013, NJAB në kuadër të MF-së, kishte kryer një auditim të brendshëm lidhur më temën “Rishikimi i Funksionimit të KKTK-së”. Ky auditim ka nxjerrë rekomandime për funksionalizimin dhe fuqizimin e KKTK-së që kryesisht kishin të bënin me faktorët e jashtëm si Qeveria dhe Kuvendi.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.2. Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financare	Në rast të korrigjimeve të tilla ne të ardhmen, të siguroj se në PVF shpalosen të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që lexuesit potencial ta kuptojnë veprimin e ndërmar si edhe efektin e mundshëm.	Po		
4.2. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Të rishqyrtoj procesin ekzistues buxhetor për kategorinë paga dhe mëditje për të siguruar përmirësimin e planifikimit dhe realizimit, si dhe të marr në konsideratë implikimet buxhetore që mund të pasojnë nga aprovimet e vendimeve menaxheriale lidhur me punën shtesë të stafit.		Menaxhmenti kishte marrë masa për këtë drejtim, mirëpo edhe me tutje nuk kishte paraparë me buxhet shtesat për paga.	
4.4.1. Prokurimi	Të sigurojë që procedurat e reviduara janë vendosur në sistem për të siguruar që kontrollet janë shtuar në kuadër të sektorit të pagesave në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar.		Menaxhmenti kishte marrë masa në këtë drejtim, mirëpo edhe me tutje në një rast është vërejtur një keqklasifikim.	
4.4.2. Shpenzimet tjera	Paraja e imët të shpenzohet vetëm për qëllimet e përcaktuara sipas dispozitave ligjore.	Po		

4.4.3. Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Pas përfundimit të mandatit të ndalet paga për të gjithë të emëruarit publik në përputhje me kornizën e aplikueshme dhe autorizimin nga Kuvendi.	Po		
4.4.3. Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Në rast se paraqitet nevoja për aplikimin e punëve shtesë, Udhëheqja Ekzekutive e KKTK-së duhet paraprakisht të siguroj se plani për punën jashtë orarit reflekton kërkesat dhe kufizimet ligjore. Poashtu duhet të siguroj kontrole shtesë në llogaritjen e kompensimeve për punë jashtë orarit për të parandaluar tejkalimin e limitit të orëve respektivisht të kompensimit.	Po		
4.5.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Në të ardhmen me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës KKTK, të ndërmerr masat adekuate për kthimin e pajisjeve në shfrytëzim me qëllim të shfrytëzimit të tyre në mënyrë më efikase.		Pjesa me e madhe e pasurisë është kthyer nga kryetarja e këshillit, megjithatë edhe një pjesë e tyre kishte mbetur pa u kthyer.	
5. Sistemi i auditimit të brendshëm	Ka marr në konsideratë lidhjen e një marrëveshje me ndonjë institucion të pavarur për shfrytëzimin e shërbimeve të Auditimit të brendshëm.	Po		